



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 2177/ 5 prot

Datë 09.10.2023

**V E N D I M**  
**K.P.P. 1011/2023**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 09.10.2023 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Curri” SHPK & “SMO Union” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur” me Nr. REF-74269-07-04-2023, me objekt: “Ndërhyrje në infrastrukturë rrugore Faza II”, me fond limit 500.000.000 (pesëqind milion) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 24.07.2023 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

**Ankimues:** Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Curri” SHPK dhe “SMO Union”, me NIPT (J67902718S), me adresë: Rruga “Kajo Karafili”, Nd. 2, H. 4, Ap. 3, Tiranë.

**Autoriteti Kontraktor:** Fondi Shqiptar i Zhvillimit.  
Adresa: Rruga “Sami Frashëri”, nr. 10, Tiranë.

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për

*miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” , Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -t9”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **Vëren:**

### **I**

#### *Vlerësimi paraprak*

I t. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën t, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.2. Bashkimi i operatorëve ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Bashkimi i operatorëve ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.t. Në datën 05.07.2023, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur” me Nr. REF-74269-07-04-2023, me objekt: “Ndërhyrje në infrastrukturë rrugore Faza II”, me fond limit 500.000.000 (pesëqind milion) lekë pa TVSH,

parashikuar për t'u zhvilluar në datën 24.07.2023 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

II.2. . Në datë 24.07.2023 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datën 26.08.2023, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Albavia” SHPK	000.000.000	lekë	skualifikuar
2. “Shkëlqimi 07” SHPK	300.000.000	lekë	skualifikuar
3. “Company Riviera 2008” SHPK	340.257.164	lekë	skualifikuar
4. BOE “Curri” & “SMO Union” SHPK	348.642.681	lekë	skualifikuar
5. “Vëllezërit Hysa” SHPK	348.839.871.60	lekë	skualifikuar
6. BOE “B933 II” & “B-93” & “Glavenica” SHPK	353.053.030	lekë	skualifikuar
7. “ANK” SHPK	362.176.985	lekë	kualifikuar
8. “GPG Company” SHPK	363.268.710	lekë	kualifikuar
9. BOE “ALB Tifebau” & “Eral Construction” SHPK	367.187.225	lekë	kualifikuar
10. “Fusha” SHPK	375.000.000	lekë	kualifikuar
tt. BOE “Alb Shpresa” & “Mela” & Mane/s” & “Sardo” SHPK	381.144.790	lekë	skualifikuar
12. BOE “2T” SHPK & “BE-IS” SHPK	387.277.388.95	lekë	kualifikuar
13. BOE “Eurokos Holding” & “Abi Cons” SHPK	393.282.300	lekë	skualifikuar
14. “Kthella” SHPK	395.087.955	lekë	skualifikuar
15. BOE “MF Invest” & ”Alko Impex General Construction” & “Sireta 2F” SHPK	396.825.500	lekë	skualifikuar
16. BOE “Elmazaj Konstruksion” & “T&XH” SHPK	396.911.400	lekë	skualifikuar
7. BOE “Almo Konstruksion” & “Ulza” SHPK	398.292.050	lekë	skualifikuar
18. “Bami Holding” SHPK	400.579.315	lekë	skualifikuar
19. “Alb Building” SHPK	413.653.890	lekë	skualifikuar
20. “Alba Konstruksion” SHPK	414.404.175	lekë	skualifikuar
21. BOE “Arifaj” & “Haziri” SHPK	432.344.304	lekë	skualifikuar
22. “Gjikuria” SHPK	455.555.551.3	lekë	skualifikuar
22. BOE “4A-M” & “Bonus” SHPK	492.815.950	lekë	skualifikuar
23. “Geci” SHPK	497.377.300	lekë	skualifikuar

II.4. Më datë 26.08.2023 autoriteti kontraktor nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike ka njoftuar bashkimin e operatorëve ekonomikë BOE “Curri” SHPK & “SMO Union” SHPK për

vlerësimin e procedurës së prokurimit, nga ku rezulton, se ky operator ekonomik është skualifikuar me arsyet si më poshtë vijojnë:

*Bashkimi i operatorëve ekonomik “SMO Union” sh.p.k & “Curri” sh.p.k nuk ploteson Kriterin per kapacitetin teknik pika 2.3.1. te Kriteve te vecante ne DT per objektin Ndërhyrje në infrastrukturë rrugore Faza II “ per sa i perket “Përvojës së suksesshme ne realizimin e puneve te ngjashme” a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së për llogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar nga operatori ekonomik gjatë pese vitet të fundit nga data e publikimit te njoftimit te kontrates ose b) Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pese viteve të fundit nga data e publikimit te njoftimit te kontrates është në një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Konkretisht, anetaret pjesemarres te bashkimit te operateve “SMO Union” sh.p.k & “Curri” sh.p.k nuk plotesojne kriterin per pune te ngjashme ne vlere sipas perqindjes (%) se marre persiper ne kete bashkim. Në bazë të përcaktimeve të legjislacionit për prokurimin publik, të parashikuara edhe në dokumentet e tenderit, bazuar edhe në konceptin e pergjithshëm të prokurimeve, objektet/ kontratat e ngjashme që të mund të konsiderohen të tilla duhet të plotësojnë në mënyrë kumulative elementin e kohës, vlerës dhe natyrës së ngjashme. Pra, (i) objekti i përfunduar i kontratës duhet të jenë brenda afatit (elementi kohë), (ii) duhet të plotësojnë madhësinë e kërkuar nga autoriteti kontraktor, 50% apo 200% (elementi vlerë) dhe (iii) duhet të jenë të ngjashme me objektin që prokurohet (elementi natyrë e ngjashme). Mungesa qoftë edhe një prej ketyre elementëve e bën të pavlefshëm eksperiencën e ngjashme të paraqitur nga kandidati ofertues.*

II.5. Në datën 01.09.2023, autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit në Sistemin e Prokurimit Elektronik..

II.6. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 06.09.2023 nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike, bashkimi i operatorëve ekonomikë “Curri” SHPK & “SMO Union” SHPK ka paraqitur njëkohësisht ankesën me numër elektronik A/2023/3397, dhe me numër 2177/2023 datë 06.09.2023, pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Gjithashtu, ky bashkim operatorësh më datë 07.09.2023 ka paraqitur fizikisht pranë Komisionit Prokurimit Publik të njëjtën ankesë protokolluar me nr. 2177/3 prot, datë 07.09.2023. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “Curri” SHPK & “SMO Union” SHPK.

II.7. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të

procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. 2177/2 Prot., date 07.09.2023, duke referuar arsyet mbi skualifikimin e ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Curri” SHPK & “SMO Union” SHPK, nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr. 2979/2 prot., datë 12.09.2023 protokolluar me tonën me nr. 2177/4 prot., datë 14.09.2023 është depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacioni, dokumentacioni si dhe vendimi mbi trajtimin e ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit. Referuar shkresës së autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Curri” SHPK & “SMO Union” SHPK dhe me shkresën nr. 2979/1 prot., datë 12.09.2023 ka njoftuar bashkimin e operatorëve ekonomikë ankimues me vendimin e K.Sh.A me të cilin ka vendosur mospranimin e ankesës.

II.9. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 për prokurimin publik.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj,

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Curri” SHPK & “SMO Union” SHPK, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së paraqitur prej tij, në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi me arsyen se: “[...]Bashkimi i operatorëve ekonomik “SMO Union” sh.p.k & “Curri” sh.p.k nuk ploteson Kriterin per kapacitetin teknik pika 2.3.1. te Kriteve te vecante ne DT per objektin Ndërhyrje në infrastrukturë rrugore Faza II “ per sa i perket “Përvojës së suksesshme ne realizimin e puneve te ngjashme” a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së për llogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar nga operatori ekonomik gjatë pese vitet të fundit nga data e publikimit te njoftimit te kontrates ose b) Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pese viteve të fundit nga data e publikimit te njoftimit te kontrates është në një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Konkretisht, anetaret pjesemarrës te bashkimit te operatoreve “SMO Union” sh.p.k & “Curri” sh.p.k nuk plotesojne kriterin per pune te ngjashme ne vlere sipas perqindjes (%) se marre persiper ne kete bashkim. Në bazë të përcaktimeve të legjislacionit për prokurimin publik, të parashikuara edhe në dokumentet e tenderit, bazuar edhe në konceptin e pergjithshëm të prokurimeve, objektet/ kontratat e ngjashme që të mund të konsiderohen të tilla duhet të plotësojnë në mënyrë kumulative elementin e kohës, vlerës dhe natyrës së ngjashme. Pra, (i) objekti i përfunduar i kontratës duhet të jenë brenda

afatit (elementi kohë), (ii) duhet të plotësojnë madhësinë e kërkuar nga autoriteti kontraktor, 50% apo 200% (elementi vlerë) dhe (iii) duhet të jenë të ngjashme me objektin që prokurohet (elementi natyrë e ngjashme). Mungesa qoftë edhe një prej këtyre elementëve e bën të pavlefshëm eksperiencën e ngjashme të paraqitur nga kandidati ofertuese[....]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 7/2 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.1 “Kapaciteti teknik” i dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

**Pika 2.3.1/a**, plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me:

- Kontratën/at e Sipërmarrjes
- Fature tatimore e situacionit perfunditar
- Situacioni përfundimtar
- Akt kolaudimi;

III.1.2. Në shtojcën 5 “Formulari i Specifikimeve Teknike” në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

*Raport Teknik Projekti: “ Ndërhyrje në infrastrukturën rrugore, Faza II*

*Përshkrimi i përgjithshëm i projektit:*

*Nisur nga shqetësimi i përfaqësuesve të Njësitë të Veteqeverisjes Vendore (NjVV), FSHZH ka bere thirrjen per evidentimin ne terren dhe projektimin të disa prej akseve rrugore, të cilat janë me problematikë për qarkullimin e automjeteve. Verifikimi në terren do te behet kryesisht per akset rrugore, të cilat lidhin zona turistike dhe që kanë potencial për zhvillimin e ekonomisë, segmente rrugore ne zona urbane, kjo në përputhje dhe komplementare me programet e zhvillimit lokal dhe rajonal.*

*Pas rikonjcionit në terren të këtyre akseve rrugore do te perzgjidhen segmentet te cilat paraqesin demtime te shtresave rrugore, gjendja teknike e tyre është jashtë standartit dhe lëvizja e automjeteve bëhet me vështirësi si dhe konsiderohen akse me prioritet nga NjVV per t'u rehabilituar.*

*Përshkrimi teknik i projektit dhe mënyra e ndërhyrjes:*

*Implementimi i ketyre projekteve ka si qëllim të përmirësoje qarkullimin e automjeteve, njerezve dhe të rrisë sigurinë e lëvizjes.*

*Për rikonstrukcionin e rrugëve parashikohet të ndërhyhet në disa kategori punimi, te pershkruara sipas kapitujve te poshteshenuara:*

#### **Rubrika I: Punime prishje dhe cmontimi**

Në këtë rubrikë përfshihen prishjet sipas zërave:

1	3.2	Prerje bime te vogla ø-10cm
2	An-48	Prishje struktura prej guri
3	An-49	Prishje struktura prej betoni

#### **Rubrika II: Punime gërmim – mbushje dhe skarifikimi**

Në këtë rubrikë përfshihen prishjet sipas zërave:

1	3.128/b	Germim shkemb i coptuar me ekskavator 1.0 m <sup>3</sup> , shkemb, ne themele gjeresi >2 m, me shkarkim ne mjet
2	3.99/b	Germim dheu me ekskavator zingjir 0.25 m <sup>3</sup> , ne kanale gjeresi > 2 m, pranë uji ~1m, kategoria III, me shk ne mjet
3	3.89/b	Germim dheu me eskavator me goma 0.25 m <sup>3</sup> ne kanale me gjeresi deri 2m toke e zakonshme kategori III me shk ne mjet (kasonete, trup rruge, veprat evogla te artit,ne themele, kanale , kunete)
4	3.124/1a	Germim shkemb mesatar me çekiç me ekskavator me zinxhir
5	3.124/2a	Germim shkemb i forte me çekiç me ekskavator me zinxhir
6	An.124/3a	Germim shkemb sek i lire, me mina te vogla,me ekskavator 1 m3 + transport
7	3.161/1	Rrafshim skarpate ne germim
8	An.164/1a	Mbushje me material te germuar ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri
9	An.164/1b	Mbushje me cakell e gur guore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri
10	3 An	Skarifikim shtrese asfalti me makineri
11	3.158/5a	Transport dheu me auto 5.0 km

### Rubrika III: Punime Shtresash

Në këtë rubrikë përfshihen prishjet sipas zërave:

1	An-31	Gjeotekstil me gramature 180g/m <sup>2</sup>
2	3.198	Cilindrim kasonete me rul
3	3.212	Shtrese cakulli t =10/15cm makadam perhapur dhe ngjeshur me makineri
4	3.211	Shtrese cakelii mbeturine kave, t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri
5	3.205/2	Shtrese zhavori lumi t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri
6	3.212/b	Shtrese stabilizanti t = 10cm
7	3.229/1	Shtrese binderi me zall lavatrice,5cm,me makineri
8	3.229/2	Shtrese binderi me zall lavatrice,6cm,me makineri
9	3.231/1	Shtrese asfaltobetoni me zall lavatrice, 3cm, me makineri
10	3.233/1	Shtrese asfaltobetoni me zall lavatrice,4cm,me mak
11	3.212/b	Shtrese stabilizanti t = 10cm (per bankina)

### Rubrika IV: Punime trotuari

Në këtë rubrikë përfshihen prishjet sipas zërave:

1	3.244/1	Struktura te holla monolite betoni C 20/25 (bordura e pasme)
2	3.24	Struktura monolite betoni c12/15 (fiksime bordure)
3	3.619/a	Bordura betoni 6x20 cm (per pemet)
4	3.617/a	F.V. Bordura betoni 15x30 cm (ruge)
6	3.617	Bordura betoni 15x25 cm
6	3.212/b	Shtrese stabilizanti t = 10cm
7	3.62	Trotuar, me t = 6cm beton me pllaka
8	4.141/a7.0	F.V. shirit sinjalizimi per fiber optike
9	3.654/1	F.V. tub brinjezuar plastik Ø 90 (linja rezerve)
10	An-9	Mbushje me zhavorr pas mureve (per trupin e trotuarit dhe mbi tubo)

### Rubrika V: Punime betoni, B/Arme dhe mure mbajtëse

Në këtë rubrikë përfshihen prishjet sipas zërave:

1	3.248	Struktura monolite betoni me çakell C 30/37 (mure + soletone)
2	3.245	Struktura monolite betoni C 25/30
3	3.244	Struktura monolite betoni C-20/25 (veshje kanali, portale,mure, etj)
4	3.243	Struktura monolite betoni C 16/20 (themele mure rrethues )
5	3.24	Struktura monolite betoni C 12/15
6	2.166	F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm
7	2.167	F V hekur betoni periodik Ø > 10 mm
8	3.323	Mur guri mbajtes e themele , llac cemento M 500
9	3.331	Gabiona me rrjete teli te zinguar e gure kave 1x1x1 m
10	3.332	Gabiona me rrjete teli te zinguar, gure kave 1x1x1.5 m
11	An-9	Mbushje me zhavorr pas mureve
12	3.654/1	Tuba drenimi PVC D=80 mm
13	3.654	Tuba drenimi PVC D=100 mm



## Rubrika VI: Punime për KUB dhe tombino

Në këtë rubrikë përfshihen prishjet sipas zërave:

1	3.89/b	Germim dheu me eskavator me goma 0.25m <sup>3</sup> ne kanale me gjeresi deri 2m toke e zakonshme kategori III me shk ne mjet
2	3.24	Struktura monolite betoni C 12/15, (shtresa e betonin nen themelin e murit, nen tombinot box, shtrat+ fiksime bordure)
3	3.244	Struktura monolite betoni C 20/25 (beton per kemishim / veshje argjinature, pusetat dhe portalet te tombinot rrethore)
4	3.624	H / Izolim me emulsion, 2 duar bitum
5	2.519	Tub kanalizimi pvc Ø 90 mm
6	3.364	Tombino me tuba betoni Ø 500, mbi shtrese betoni
7	3.365	Tombino me tuba betoni Ø 600, mbi shtrese betoni
8	3.366	Tombino b/a me tuba betoni Ø 800, mbi shtrese betoni
9	3.367	Tombino me tuba betoni Ø 1000, mbi shtrese betoni
10	3.369	Tombino me tuba betoni Ø 1500, mbi shtrese betoni
11	3.652	F.V. tuba tubo plastmasi d=200 mm (KUB)
12	3.An/1t	F.V. Tuba te brinjezuara HDPE SN d=315mm
13	3.An/2t	F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=400 mm
14	3.An/3t	F V Tuba te brinjezuar HDPE SN8 Ø500 mm (per shkarkimin e ujrave te shiut)
15	2.261	Shtrese rere
16	An-9	Mbushje me zhavorr pas mureve ( mbi tuba)
17	2.575	Puse kontrolli 1x1x1.5m
18	An - 23	Pusete b/a shiu 40 x 60, h = 100 cm, me kapak gize
19	An - 22/1	Pusete b/a shiu 40 x 40, h = 100 cm, me kapak gize (KUB)
20	An-20	Puseta kontrolli 80x80, h=150cm KUB +kapak gize per ujrak e shiut
21	3.158/5a	Transport dheu me auto 5.0 km

## Rubrika VII: Punime ujësjellësi , linja kryesore

Në këtë rubrikë përfshihen prishjet sipas zërave:

1	3.89/b	Germim dheu me eskavator me goma 0.25m <sup>3</sup> ne kanale me gjeresi deri 2m toke e zakonshme kategori III me shk ne mjet
2	2.261	Shtrese rere
3	An-9	Mbushje me zhavorr ( mbi tuba)
4	2.491/g	F.V.Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=90mm, t = 6.7 mm, PN 10
5	2.491/j	F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=160 mm, t = 8.1 mm, PN 10
6	3.158/5a	Transport dheu me auto 5.0 km

## Rubrika VIII: Punime elektrike

Në këtë rubrikë përfshihen prishjet sipas zërave:

1	3.89/b	Germim dheu me eskavator me goma 0.25m <sup>3</sup> ne kanale me gjeresi deri 2m toke e zakonshme kategori III me shk ne mjet
3	AN - 1	Spostim shtyllash elektrike
4	3.An/55	F.Montim shtylle konike 9ml , LED me nje krahe cdo 30ml perfshire te gjithë aksesoret e nevojshem.
5	2.114/1	Plinta e bazamente b/a monolite C 16/20
6	3.An/53	F V shtylla metalike per ndricim, H=7m, d=160mm
7	3An/53+An	F.V shtylla metalike per ndricim komplet h= 8 ml,d=160 mm
8	3.An/ksh	FV krah shtylla metalike KRH - MSI 1500/1500/10
9	3.An	FV ndricues Smart VP CL1 CR M-S 250W GG FAE 44004,me llampe 250W 230V
11	4.150/7	F.V. percjellesa Cu 16mm <sup>2</sup>
12	AN-2	F.V. Kabell FG7OR 0.6/ 1KV, 5x6mm <sup>2</sup>
14	4.142/1.29	F.V kabell te vendosur ne toke 4*4 mm <sup>2</sup>
15	2.482/1	F.V kabell 3*1.5 mm <sup>2</sup>
16	3.An/pp	F.V puseta elektrike pvc 40*40*40 kapak te forte RIC 1084+1086
17	3.An/et	F.V elektroda togezime te xinguara 50x30 mmL=150 cm
20	An	F V kuader komandimi komplet me santeri+fotoelement
21	AN-4	F.V. tuba te brinjezuar Ø100mm per linjen rezerve
22	3.654/1	F.V. tub brinjezuar plastik Ø 90 (linja rezerve)
23	3.654/1	Furnizim, vendosje tuba plastmasi Ø 80 (linjat rezerve inxh.)
25	An.57	F.V. Tuba metalik D=219mm per kalimin e tubit ne veprat e artit
27	4.141/a7.0	F.V. shirit sinjalizimi per fiber optike
28	3.158/5a	Transport dheu me auto 5.0 km

## Rubrika IX: Punime sinjalistike dhe gjelbërim

Në këtë rubrikë përfshihen prishjet sipas zërave:

1	3.An 105	Tabela trekendore vogla me A=60
2	An106	Tabela trekendore normal me A = 90
3	An97	Tabela tetekendore normal me A-B, 90-30 (STOP)
4	3.An 96	Tabela tetekendore vogel me A-B, 60-20
5	3.An 102	Tabela rrethi "ndalimi" e vogla me D=40
6	An48	Tabele katrore normal A=60
7	An50	Tabele drejtkendore (treguese) (AXB) e zvogeluar 40x60
8	An155	F V tabela rugore te ndryshme D=90cm
9	An158	FV tabela te ndryshme rrugore D=60cm ( +per kembesoret)
10	An157	F V tabela rugore treguese 60x20cm
11	An156	F V tabela rugore treguese 150x40cm
12	An64	Sinjalet e drejtimit urban HxL normal 25x125 (fshatrat)
13	An116	Pervijues normal anesor (Delinatore)
14	An119	Pervijues modulare te kthesave (cifte)
15	An153	F.V reflektor asfalti (symace)
16	An148	F.V. Kurrize artificiale h =3cm
17	An122	Vijezim shirita gjatesor dhe anesor me gjeresi 12 cm. Bikoponente (sprajt)
18	An151	Vijezime me boje bikomponente (vijezime kembesoresh, shigjeta drejtimi, kryqezime etj.)
19	An143	Boje bikomponente (paste) per kalim kembesoresh
20	An2	Guardrail- N2 anesore me 2 valez. ne 1 ane , W3 + aksesoret
21	An164	F.V. Fidane Peme dekorative

III.1.3. Në përmbushje të kriterit të mësipërm, bashkimi i operatorëve ekonomikë “Curri” SHPK & “SMO Union” SHPK ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), dokumentacionin si më poshtë:

Kontratë Bashkëpunimi e lidhur më datë 22.07.2023, në Tiranë, midis operatorit ekonomik “Curri” SHPK dhe operatorit ekonomik “SMO Union” SHPK. Sipas nenit 1 Objekti i kësaj kontratë është krijimi i bashkimit të përkohëshëm të shoqërive me qëllimin e pjesëmarrjes në procedurën e prokurimit me REF-74269-07-04-2023, me objekt “Ndërhyrje në infrastrukturë rrugore Faza II”, që zhvillohet nga autoriteti kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Në nenin 4 të kësaj kontrate janë përcaktuar nga palët edhe kontributet e tyre, ku shoqëria “Curri” SHPK merr përsipër 50.96 % të vlerës së preventivit të punimeve, punime të cilat përkojnë me fushën dhe aktivitetin kryesorë të shoqërisë dhe shoqëria “SMO Union” SHPK merr përsipër 49.04 % të punimeve, punime të cilat përkojnë me fushën dhe aktivitetin kryesorë të shoqërisë.

#### **Curri SHPK**

- Kontratë nr. 3349/12 prot, datë 22.05.2019, lidhur ndërmjet Bashkisë Shkodër dhe operatorit ekonomik “Curri” sh.p.k., me objekt: Loti II “Rikonstruksion rrugë Velipojë Plazh Loti i II-të”, me vlerë të realizuar XX,XXX,XXX lekë me TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi, situacione, akt kolaudim, certifikate e marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore.
- Kontratë nr. 1054/2 prot., datë 29.05.2020, lidhur ndërmjet Fondit Shqiptarë të Zhvillimit dhe bashkimit të operatorëve ekonomik “Curri” sh.p.k 50.001% & “Alba Konstruksion” sh.p.k 49.999 % me objekt: “Përmirësim i nyjes së Hyrjes – Daljes Fishtë dhe përmirësimi i shtresave rrugore për segmentin Rrugë Nacionale – Fishtë, L=3,050 ml” dhe “Përmirësim i shtresave rrugore në segmentin: Rrethrotullimi i rrugës Nacionale Koplík – Kryqëzimi Dedaj L = 11,900 ml, Bashkia Malësi e Madhe” me vlerë të realizuar XXX,XXX,XXX lekë me TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi, situacion, akt kolaudimi, certifikate e marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore.
- Kontratë nr. 1656 prot., datë 27.07.2020, lidhur ndërmjet Fondit Shqiptarë të Zhvillimit dhe bashkimit të operatorëve ekonomik “Curri” sh.p.k 50.001% & “Alba Konstruksion” sh.p.k 49.999 % me objekt: “Përmirësimi i shtresave rrugore Boboshticë – Dardhë L = 9480m” me vlerë të realizuar XX,XXX,XXX lekë me TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi, situacion, akt kolaudimi, certifikate e marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore.
- Kontratë nr. 1378 prot., datë 26.06.2020, lidhur ndërmjet Fondit Shqiptarë të Zhvillimit dhe bashkimit të operatorëve ekonomik “Curri” sh.p.k 50.001% & “Alba Konstruksion” sh.p.k 49.999 % me objekt: “Përmirësimi i shtresave rrugore në unazën e qytetit Pukë L=1000m” me vlerë të realizuar XX,XXX,XXX lekë me TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi, situacion, akt kolaudimi, certifikate e marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore.

- Kontratë nr. 1612 prot., datë 27.04.2021, lidhur ndërmjet Fondit Shqiptarë të Zhvillimit dhe bashkimit të operatorëve ekonomik “Curri” sh.p.k 50.001% & “Alba Konstruksion” sh.p.k 49.999 % me objekt: “Përmirësimi i shtresave rrugore në Rrugë të brendshme në qytetin Korçë, në Drenovë dhe në Boboshticë” me vlerë të realizuar XX,XXX,XXX lekë me TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi, situacion, akt kolaudimi, certifikate e marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore.
- Kontratë nr. 4547/5 prot., datë 05.09.2016, lidhur ndërmjet Autoritetit Rrugor Shqiptar dhe operatorit ekonomik “Curri” sh.p.k me objekt: “Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore me performancë e aksit rrugor Qafë Laç – Koman, 32.4 km” me vlerë të realizuar XX,XXX,XXX lekë me TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi, situacion, akt i marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore.
- Kontratë nr. 4541/5 prot., datë 21.09.2016, lidhur ndërmjet Autoritetit Rrugor Shqiptar dhe operatorit ekonomik “Curri” sh.p.k me objekt: “Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore me performancë e aksit rrugor Qafë Bualli – Krastë, 17.7 km” me vlerë të realizuar XX,XXX,XXX lekë me TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi, situacion, akt i marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore.
- Kontratë nr. 337 prot., datë 02.12.2020, lidhur ndërmjet Drejtoria e Rajonit Jugor Gjirokastër dhe operatorit ekonomik “Curri” sh.p.k me objekt: “Mirëmbajtje rutinë me performancë rruga Tepelenë – Dukaj + rruga K/Salari – Sevastër + rruga Sevastër – Qaf Dushk + rruga Sevastër – Kalivaç + rruga Peshkëpi – Gjormë + rruga Bypass Tepelenë 84 km” me vlerë të realizuar XX,XXX,XXX lekë me TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi, situacion, akt i marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore.
- Kontratë nr. 5693/5 prot., datë 14.02.2019, lidhur ndërmjet Bashkisë Vorë dhe operatorit ekonomik “Curri” sh.p.k me objekt: “Rikonstruksion i rrugës industriale pranë Terminalit të Doganës së Tiranës Bashkia Vorë” me vlerë të realizuar XX,XXX,XXX lekë me TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi, situacion, akt kolaudimi, akt i marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore.
- Kontratë nr. 14800/7prot., datë 27.09.2017, lidhur ndërmjet Bashkisë Tiranë dhe operatorit ekonomik “Curri” sh.p.k me objekt: “Rikonstruksion i Infrastrukturës rrugore të bllokut të kufizuar nga rrugët Zogu i I – rruga e Dibrës – Siri Kodra – dhe Reshit Petrela” me vlerë të realizuar XXX,XXX,XXX lekë me TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi, situacion, akt kolaudimi, akt i marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore.
- Kontratë nr. 8 prot., datë 06.04.2021, lidhur ndërmjet Drejtoria e Rajonit Qendror Tiranë dhe operatorit ekonomik “Curri” sh.p.k me objekt: “Mirëmbajtje me performancë Librazhd – Steblevë, Urakë – Golik, Hotolisht – Frarë, Qukës – Qafë Plloçë Loti 1” me vlerë të realizuar XX,XXX,XXX lekë me TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi, situacion, akt i marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore.

- Kontratë nr. 8 prot., datë 11.12.2020, lidhur ndërmjet Autoritetit Rrugor Shqiptare dhe operatorit ekonomik “Curri” sh.p.k me objekt: “*Mirëmbajtje me performancë Librazhd – Steblevë, Urakë – Golik, Hotolisht – Frarë, Qukës – Qafë Plloçë Loti 1*” me vlerë të realizuar XX,XXX,XXX lekë me TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi, situacion, akt i marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore.
- Kontratë nr. 4618 prot., datë 17.07.2018, lidhur ndërmjet Bashkia Malësi e Madhe dhe operatorit ekonomik “Curri” sh.p.k me objekt: “*Rikualifikim i sheshit në Koplík Sipërm*” me vlerë të realizuar X,XXX,XXX lekë me TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi, situacion, akt kolaudim, akt i marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore.
- Kontratë nr. 96 prot., datë 25.01.2021, lidhur ndërmjet Këshillit Qarkut Tiranë dhe operatorit ekonomik “Curri” sh.p.k me objekt: “*Sistemim, asfaltim rruga Cekrez – Morinë (lagja e kodralinjve) Njësia Administrative Zall-Herr*” me vlerë të realizuar XX,XXX,XXX lekë me TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi, situacion, akt kolaudim, akt i marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore.
- Kontratë nr. 1703 prot., datë 19.06.2017, lidhur ndërmjet Bashkisë Malësi e Madhe dhe operatorit ekonomik “Curri” sh.p.k me objekt: “*Rikualifikim i Qendrës Bajzë Kastrati, Loti 1*” me vlerë të realizuar XX,XXX,XXX lekë me TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi, situacion, akt kolaudim dhe fatura tatimore.
- Kontratë nr. 5601 prot., datë 07.11.2019, lidhur ndërmjet Bashkisë Malësia e Madhe dhe bashkimit të operatorëve ekonomikë “Curri” sh.p.k 59.1% dhe “Sterkaj” SHPK 40.9 % me objekt: “*Furnizim me ujë i zonës Koplíkut Qendër dhe Koplík i Sipërm*” me vlerë të realizuar XXX,XXX,XXX lekë me TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi, situacion, akt kolaudim, akt i marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore.
- Kontratë nr. 1703 prot., datë 19.06.2017, lidhur ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizime dhe operatorit ekonomik “Curri” sh.p.k me objekt: “*Rikonstruksion i Ujësjellësit të Lagjes 28 Nëntori dhe Skëndërbeu në qytetin e Elbasanit*” me vlerë të realizuar XXX,XXX,XXX lekë me TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi, situacion, akt kolaudim, akt i kolaudimit dhe fatura tatimore.
- Kontratë nr. 1075 prot., datë 19.03.2020, lidhur ndërmjet Bashkisë Prrenjas dhe operatorit ekonomik “Curri” sh.p.k me objekt: “*Rikonstruksion rrjetit shpërndarës i ujësjellësit Prrenjas*” me vlerë të realizuar XXX,XXX,XXX lekë me TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi, situacion, akt kolaudimi, certifikate e marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore.

### **SMO Union SHPK**

- Kontratë Referenca P/Punë/2018/GOA/P-14, datë 13.12.2018, lidhur ndërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe bashkimit të operatorëve ekonomikë “SMO Union” sh.p.k 54 % & “Shkëlqimi 07” SHPK 46 %, me objekt: “*Rikonstruksion i Unazës Bujqësore të*

*Myzeqesë Segmentet Rrethrotullimi – Imesht – Ngurrës, Fier i Ri – Kashtbardh, Qerret – Kadiaj – Savër Loti I*”, me vlerë të realizuar XXX,XXX,XXX lekë me TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi, akt kolaudimi, certifikata e marrjes në dorëzim, situacione dhe fatura tatimore.

- Kontratë nr. 7949/5 prot., datë 19.11.2019, lidhur ndërmjet Autoritetit Rrugor Shqiptar dhe bashkimit të operatorëve ekonomik “Blerimi” sh.p.k 47 % & “SMO Union” sh.p.k 48 % & “A.SH Engineering” sh.p.k 5 %, me objekt: “Ndërtim mure mbajtës dhe pritës në segmentin Kuben-Vasije”, me vlerë të realizuar XX,XXX,XXX lekë me TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi, situacione, akt kolaudimi dhe fatura tatimore.
- Kontratë nr. 4697/15 prot., datë 31.08.2018, lidhur ndërmjet Bashkisë Shkodër dhe operatorit ekonomik “SMO Union” sh.p.k, me objekt: “Sistemim asfaltim rruga Qendër Mes – Qendër Dragoc”, me vlerë të realizuar XX,XXX,XXX lekë me TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi, situacione, akt kolaudimi, certifikatë e marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore.
- Kontratë nr. 2580 prot., datë 29.03.2019, lidhur ndërmjet Bashkisë Lushnje dhe operatorit ekonomik “SMO Union” sh.p.k, me objekt: “Sistemim asfaltim i rrugës në fshatin Lekaj”, me vlerë të realizuar XX,XXX,XXX lekë me TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi, situacione, akt kolaudimi, certifikatë e marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore.
- Kontratë nr. 3822 prot., datë 07.05.20t9, lidhur ndërmjet Bashkisë Lushnje dhe operatorit ekonomik “SMO Union” sh.p.k, me objekt: “Sistemim asfaltim i rrugës në fshatin Rrapëz”, me vlerë të realizuar XX,XXX,XXX lekë me TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi, situacione, akt kolaudimi, certifikatë e marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore.
- Kontratë nr. 8891/15 prot., datë 04.09.2019, lidhur ndërmjet Bashkisë Shkodër dhe operatorit ekonomik “SMO Union” sh.p.k, me objekt: “Rikonstruksion Rruga Zabelej”, me vlerë të realizuar XX,XXX,XXX lekë me TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi, situacione, akt kolaudimi, certifikatë e marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore.
- Kontratë nr. 9261/15 prot., datë 19.08.2019, lidhur ndërmjet Bashkisë Shkodër dhe operatorit ekonomik “SMO Union” sh.p.k, me objekt: “Sistemim asfaltim rruga Ura Mesit – Drisht”, me vlerë të realizuar XX,XXX,XXX lekë me TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi, situacione, akt kolaudimi, certifikatë e marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore.
- Kontratë nr. 4127/7 prot., datë 21.09.2018, lidhur ndërmjet Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare dhe operatorit ekonomik “SMO Union” sh.p.k, me objekt: “Mbrojtja e anës së majtë të biefit të sipërm të Digës së Fierzës dhe ndërtimi i vendparkimit të mjeteve lundruese në HEC Fierzë”, me vlerë të realizuar XX,XXX,XXX lekë me TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi, situacione, akt kolaudimi, certifikatë e marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore.

- Kontratë nr. 1283 prot., datë 03.10.2018, lidhur ndërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe bashkimit të operatorëve ekonomik “Nika” sh.p.k 75 % & “SMO Union” sh.p.k 25 %, me objekt: “*Rikualifikim urban i Tamarës faza e dytë dhe rikonstruksion i rrugës së Vermoshit*”, me vlerë të realizuar XX,XXX,XXX lekë me TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi, situacione, akt kolaudimi, certifikate e marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore.
- Kontratë nr. 2682 prot., datë 02.11.2020, lidhur ndërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe operatorit ekonomik “SMO Union” sh.p.k, me objekt: “*Rikonstruksioni i Rrugës nga kryqëzimi Dardhë – Arrëz deri në fshatin Nikolicë*”, me vlerë të realizuar XXX,XXX,XXX lekë me TVSH, shoqëruar me situacione, akt kolaudimi dhe fatura tatimore.
- Kontratë nr. 6149 prot., datë 21.09.2022, lidhur ndërmjet Bashkisë Krujë dhe operatorit ekonomik “SMO Union” sh.p.k, me objekt: “*Sistemim asfaltim i rrugës Halil – Zgërdhesh (Kala)*”, me vlerë të realizuar XX,XXX,XXX lekë me TVSH, shoqëruar me situacione, akt kolaudimi dhe fatura tatimore.
- Kontratë nr. 24573/8 prot., datë 14.02.2022, lidhur ndërmjet Bashkisë Shkodër dhe operatorit ekonomik “SMO Union” sh.p.k, me objekt: “*Sistemim asfaltim i rrugës Oblike Qendër – Lagjia Lami dhe Rashkej*”, me vlerë të realizuar XX,XXX,XXX lekë me TVSH, shoqëruar me situacione, akt kolaudimi, certifikatë e marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore.
- Kontratë nr. 6117 prot., datë 21.09.2022, lidhur ndërmjet Bashkisë Krujë dhe operatorit ekonomik “SMO Union” sh.p.k, me objekt: “*Sistemim asfaltim i rrugëve Lagja në Lindje të Superstradës, Qendër Thumanë Krujë*”, me vlerë të realizuar XX,XXX,XXX lekë me TVSH, shoqëruar me situacione, akt kolaudimi dhe fatura tatimore.
- Kontratë nr. 6133 prot., datë 21.09.2022, lidhur ndërmjet Bashkisë Krujë dhe operatorit ekonomik “SMO Union” sh.p.k, me objekt: “*Sistemim asfaltim i rrugëve Vlash Dobrozi, Dashamiri, e Hekurudha, Njësia Administrative Thumanë, Krujë*”, me vlerë të realizuar XX,XXX,XXX lekë me TVSH, shoqëruar me situacione, akt kolaudimi dhe fatura tatimore.
- Kontratë nr. 2803 prot., datë 29.04.2021, lidhur ndërmjet Bashkisë Krujë dhe operatorit ekonomik “SMO Union” sh.p.k, me objekt: “*Sistemim asfaltim i rrugëve së Ukëve, tapizë, Njësia Administrative Nikël, Krujë*”, me vlerë të realizuar X,XXX,XXX lekë me TVSH, shoqëruar me situacione, akt kolaudimi, akt marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore.
- Kontratë nr. 2809 prot., datë 29.04.2021, lidhur ndërmjet Bashkisë Krujë dhe operatorit ekonomik “SMO Union” sh.p.k, me objekt: “*Sistemim asfaltim i rrugës Engjëlli, Fshati Bilaj, Njësia Administrative Bubq, Krujë*”, me vlerë të realizuar X,XXX,XXX lekë me TVSH, shoqëruar me situacione, akt kolaudimi dhe fatura tatimore.

- Kontratë nr. 313/12 prot., datë 08.04.2021, lidhur ndërmjet Bashkisë Durrës dhe operatorit ekonomik “SMO Union” sh.p.k, me objekt: “Rikonstruksion rruga Tepelena”, me vlerë të realizuar XX,XXX,XXX lekë me TVSH, shoqëruar me situacione, akt kolaudimi dhe fatura tatimore.
- Kontratë nr. 4036/5 prot., datë 04.10.2018, lidhur ndërmjet Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare dhe operatorit ekonomik “SMO Union” sh.p.k, me objekt: “Evadim i materialeve të ngurta në zonën poshtë urës deri tek bashkimi me lumin e Valbonës në HEC Fierzë”, me vlerë të realizuar XXX,XXX,XXX lekë me TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi, situacione, akt kolaudimi, certifikatë e marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore.
- Kontratë nr. 4269/8 prot., datë 09.10.2017, lidhur ndërmjet Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare dhe bashkimit të operatorëve ekonomik “SMO Union” sh.p.k 70 % & “Curri” sh.p.k 30 %, me objekt: “Rikonstruksion i rrugës nga vepra e marrjes tek hyrja e HEC Koman”, me vlerë të realizuar XXX,XXX,XXX lekë me TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi, situacione, akt kolaudimi, certifikatë e marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore.
- Kontratë lidhur më datë 15.09.2018, ndërmjet shoqërisë “SMO Union” shpk dhe shoqërisë “Curri” sh.p.k, me objekt: “Rehabilitimi i digës së Gjocaj në Hec Vau Dejës”, me vlerë të realizuar XXX,XXX,XXX lekë me TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi, situacione, akt kolaudimi, certifikatë e marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore.
- Kontratë lidhur më datë 23.05.2019, ndërmjet shoqërisë “SMO Union” sh.p.k dhe shoqërisë “Curri” sh.p.k, me objekt: “Rikonstruksion rruge Velipojë, Plazh, Loti II”, me vlerë të realizuar XX,XXX,XXX lekë me TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi, situacione, akt kolaudimi, certifikatë e marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore.

III.1.4. Në kthimin e përgjigjes lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes autoriteti kontraktor argumenton se:

*“Më datë 07.09.2023, BOE “Curri” ShPK & “SMO Union” ShPK ka paraqitur ankesë protokolluar nga FSHZH me nr. 2979 prot, datë 07.09.2023 dhe njëkohësisht në Komisionin e Prokurimit Publik i cili ka publikuar në bazën e të dhënave formularin e publikimit Nr. 2t77/2 prot, datë 07.09.2023, duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij ekonomike, duke argumentuar se ky BOE në këtë procedurë prokurimi ka paraqitur kontrata të ngjashme të realizuara gjatë 5 viteve të fundit duke plotësuar kërkesën e dyfishit të vlerës së fondit limit që prokurohet. Komisioni i shqyrtimit të ankesave pa shqyrtimit të ankesës dhe dokumentacionit bashkëngjitur arsyeton se: Në dokumentet standarde të tenderit shtojca 7, në pikën 2.3.1 është përcaktuar se: **2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të***



fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose **b**) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. **Pika 2.3.1/a**, plotësohet nga anëtarë i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme: Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me: - Kontratën/at e Sipërmarrjes; - Fature tatimore e situacionit përfunditar; - Situacioni përfundimtar; - Akt kolaudimi. Në bazë të përcaktimeve të legjislacionit për prokurimin publik, të parashikuara edhe në dokumentet e tenderit, bazuar edhe në konceptin e përgjithshëm të prokurimeve, objektet/kontratat e ngjashme që të mund të konsiderohen të tilla duhet të plotësojnë në mënyrë kumulative elementin e kohës, vlerës dhe natyrës së ngjashme. Pra, (i) objekti i përfunduar i kontratës duhet të jetë brenda afatit (elementi kohë), (ii) duhet të plotësojnë madhësinë e kërkuar nga autoriteti kontraktor, 50% apo 200% (elementi vlerë) dhe (iii) duhet të jenë të ngjashme me objektin që prokurohet (element natyrë e ngjashme). Mungesa qoftë edhe një prej këtyre elementëve e bën të pavlefshëm eksperiencën e ngjashme të paraqitur nga kandidati ofertues”. Në përmbushje të kriterit të mësipërm, Bashkimi i operatorëve ekonomikë ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) Kontratën: - Mirëmbajtje me performancë Librazhd - Stebleve, Urake - Golik, Hotolisht Frare, Qukes - Qafe Plloce, Loti 1; - Mirembajtje Rutine dhe dimerore Qafa e Buallit - Krasht 16.7 km; - Mirembajtje Rutine dhe dimerore Qafe Lac - Koman 32.4 km. Dokumentacioni i paraqitur nga BOE ankimes, për të vërtetuar eksperiencën e mëparshme të ngjashme, nuk është në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor pasi kontratat e mësipërme janë kontrata mirëmbajtje rutinë dhe nuk mund të konsiderohen si kontrata të ngjashme ne përputhje me Termat e references. Gjithashtu dhe kontratat me objekt: - Rikonstruksion i rrjetit shpërndarës Bashkia Prrenjas 25.07.2022, me vlerë XXX,XXX,XXX; - Rikonstruksion i ujësjellësit të lagjes 28 nëntori dhe Skënderbeu, në qytetin e Elbasanit 06.12.2018, me vlerë XXX,XXX,XXX; - Furnizimi me ujë i zonës së Koplikut Qendër dhe Koplik i Sipërm 28.12.2021, me vlerë XXX,XXX,XXX. nuk janë kontrata që vërtetojnë eksperiencën e mëparshme të ngjashme, pasi nuk janë në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, pasi kontrata Furnizimi me ujë i zonës së Koplikut Qendër dhe Koplik i Sipërm nuk përputhet me elementin e natyrës së ngjashme pasi nuk bazohet në natyrën, kompleksitetin dhe/ose karakteristika të tjera të përshkruara në raportin Teknik. (Sqarim: Punimet e furnizimit me ujë të parashikuara ne objektin e prokurimit zene rreth 1% të totalit të punimeve të parashikuara ne preventiv). Gjithashtu, në të njëjtën kohë po ti referohemi kontratës Rikonstruksioni i ujësjellësit të lagjes “28 Nëntori dhe Skenderbeu” në qytetin e Elbasanit, kjo

kontratë nuk plotëson elementin kohë pasi është një kontratë që është realizuar në vitin 2017-2018, pra nuk është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. KSHA gjykon, se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës, Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Sa më sipër pretendimi i BOE ankimes "CURRI" ShPK NUIS J67902718S & "S.M.O Union" ShPK NUIS J66902042Q, nuk qëndron pasi nuk provon se ka kryer punime të ngjashme me objektin e prokurimit, duke mos plotësuar kështu kërkesën për kualifikim, për përvojë të suksesshme e cila është një komponent shumë i rëndësishëm për arritjen e qëllimit të autoritetit kontraktor. Në mbështetje të nenit 114 pika 3/c të Ligjit nr. 162/2020, datë 28.12.2020 "Për prokurimin publik", nenit 102 pika 1/c VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, Komisioni për shqyrtimin e ankesave, vendosi: Refuzimin e ankesës të BOE ankimes "Curri" ShPK NUIS J67902718S & "SMO Union" ShPK NUIS J66902042Q në procedurën e prokurimit "Procedurë e hapur" – Marrëveshje Kuadër me nr. Ref-74269-07-04-2023, me objekt "Ndërhyrje në infrastrukturë rrugore Faza II".

III.1.5. Neni 77 "Kërkesat për kualifikim", të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", parashikon shprehimisht se: Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.1.6. Neni 39 pika 5 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, e VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikon shprehimisht se:

5. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.1.7. Në nenin 14 “Operatorët ekonomikë” të ligjit nr. 162/2020, datë 23 .12.2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se:

“1. Kandidatët ose ofertuesit mund të jenë persona fizikë ose juridikë.

2. Grupe operatorësh ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik. Autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet t'i kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje.

Autoritetet ose entet kontraktore mund t'u kërkojnë grupeve të operatorëve ekonomikë që të marrin një formë ligjore specifike, pasi të jenë shpallur fitues, nëse vlerësohet e nevojshme për realizimin e kontratës. Në çdo rast, ky kusht duhet t'u bëhet i ditur operatorëve ekonomikë në dokumentet e tenderit për ekzekutimin e kënaqshëm të kontratës.

3. Rregullat për mënyrën e plotësimit të kriterëve nga grupet e operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”.

III.1.8. Në nenin 88 “Bashkimi i operatorëve ekonomikë” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar përcaktohet se:

1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.
2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.
3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.
4. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje

*pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.*

- 5. Operatori ekonomik, anëtar i një bashkimi, nuk mund të paraqesë njëkohësisht edhe oferta individuale. Bashkimi i operatorëve ekonomikë nuk ndryshon pas dorëzimit të ofertës, në të kundërt oferta e tij refuzohet. Autoriteti ose enti kontraktor, para lidhjes së kontratës, mund të kërkojë që bashkimi i operatorëve ekonomikë të krijohet zyrtarisht me një marrëveshje të noterizuar.*
- 6. Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi.*
- 7. Në rast falimentimi të një prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë ose në rrethana të tjera, që ndërpresin veprimtarinë e tij gjatë zbatimit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor mund të vazhdojë kontratën me operatorin/ët e tjerë ekonomikë, anëtarë të bashkimit, me kusht që ai të zotërojë kapacitetet ligjore, ekonomike, financiare dhe teknike për të zbatuar kontratën. Përndryshe, autoriteti/enti kontraktor zgjidh kontratën.*

III.1.9. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” ka për detyrë d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepron në transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.1.10. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar, të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Curri” SHPK & “SMO Union” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se ky bashkim operatorësh ekonomik i krijuar me kontratën e bashkëpunimit të datës 22.07.2023, ka paraqitur ofertë në këtë procedurë prokurimi, ku përfaqësues i këtij bashkimi rezulton të jetë shoqëria “Curri” SHPK. Për përmbushjen e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.1 të

dokumenteve standarde të tenderit, për punime të ngjashme gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimes ka paraqitur dokumentacionin e cituar në pikën III.1.3. Nga krahasimi i kontratave të dorëzuara nga secili anëtar i këtij bashkimi operatorësh, situacioneve përfundimtare të punimeve në zbatim të kontratave të sipërcituara, të realizuara nga secili anëtar i këtij bashkimi operatorësh ekonomikë, faturave tatimore të shitjes, me preventivin, dhe relacionit të specifikimeve teknike të objektit të prokurimit, të dhëna këto në dokumentet e tenderit objekt-prokurimi, KPP gjykon të ndalet në një analizë të thelluar të dëshmive të eksperiencës së ngjashme të dorëzuar nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomike ankimes, parë kjo në rrafshin krahasimor me preventivin dhe relacionin e specifikimeve teknike të autoritetit kontraktor, për sa i përket 3 komponentëve, si komponenti kohë (ku Komisioni për këtë komponentë do të marrë në konsideratë ato kontrata të cilat janë brenda afatit kohorë 5 vjeçar nga data e njoftimit të kontratës), komponenti vlerë (lidhet me madhësinë e kontratës ose kontratave të kërkuara nga autoriteti kontraktor në kriterin 2.3.1 pra 50 % apo 200 %) si dhe komponentit natyrë e ngjashme (i cili lidhet me natyrën e ngjashme të kontratave të dorëzuara nga bashkimi i operatorëve ekonomikë me objektin e prokurimit nisur jo vetëm nga emërtesa e kontratës por edhe nga zërat e preventivave të tyre). Në rastin konkret, KPP referuar preventivit dhe relacionit të specifikimeve teknike të objektit të prokurimit gjykon, se nuk kemi të bëjmë me një projekt specifik, jo vetëm për sa i përket objektit të tij, por edhe natyrës së punimeve që janë parashikuar për t'u realizuar. Në këtë mënyrë, KPP vlerëson se kërkesa e autoritetit kontraktor referuar objektit të procedurës së prokurimit lidhet me ndërhyrje në infrastrukturë rrugore, konkretisht punime prishje dhe çmontim, punime gërmimi dhe skarifikimi, punime shtresash, punime trotuari, punime betoni, b/arme dhe mure mbajtëse, punime kub dhe tombino, punime ujësjellësi linja kryesore, punime elektrike dhe punime sinjalistike dhe gjelbërim. Në nenin 77 pika 4 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” është parashikuar se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, **si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.** Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”, KPP vlerëson se së pari, norma juridike duhet të interpretohet e më pas të gjykohet, kjo për të analizuar në thelb *ratio legis*, kuptimin e drejtë të saj. Kështu, ligjvënësi ka parashikuar diskrecionin e autoritetit kontraktor të kërimit të dëshmive për përvojën e mëparshme, me synim **për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.** Pra e drejta e dhënë nga ligji lidhet ngushtësisht me garantimin e autoritetit kontraktor, se operatori ekonomik disponon dëshmi të përvojës së mëparshme për të realizuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Gjithashtu, me akt nënligjor, diskrecioni i vendosur nga ligji është

rregulluar edhe më tej, ku në rastin e kontratave për punë publike ligjvënësi në nenin 39, pika 5 të Vendimit nr.285 datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, të ndryshuar ka parashikuar, se ky kriter në rastin e përvojës së ngjashme të mëparshme të realizuar me entet publike, mund të përmbushet me dorëzimin e vërtetimeve të lëshuara nga enti publik ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë ose me sektorin privat me paraqitjen e vërtetimeve të shoqëruar dhe me fatura tatimore ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, me një vlerë jo më të madhe se 50 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Gjithashtu, në rregullat e prokurimit publik është përcaktuar se plotësimi i njërit prej dy kushteve e bën ofertën të kualifikueshme. Duke iu kthyer kriterit, KPP konstaton, se kriteri i hartuar nga ana e autoritetit kontraktor është në përputhje me diskrecionin e dhënë nga ligji dhe akti nënligjor, si edhe afati i kërkimit të dokumentacionit është brenda periudhës pesë vjeçare sikundër parashikohet edhe në këtë Vendim të Këshillit të Ministrave. Në nenin 14 të ligjit nr. 162/2020, datë 23 .12.2020 “*Për prokurimin publik*” është parashikuar e drejta e operatorëve ekonomikë që të paraqesin oferta në procedurat e prokurimit në formën e grupeve të operatorëve ekonomikë, ndërkohë që në nenin 88 ë Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285 datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, është përcaktuar detyrimi që këto grupe operatorësh ekonomikë duhet të krijohen nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi, ku të përcaktojnë qartë zërat konkret të shërbimit apo punimit apo furnizimit me mall që merr përsipër secili prej anëtarëve të këtij grupi dhe përqindjen e bashkëpunimit, si dhe kërkesat për kualifikim të natyrës ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Sa më sipër, në analizë të thelluar dhe krahasimore të kontratave të dorëzuara nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues, KPP konstaton, se me anë të dokumentacionit të dorëzuar dëshmojnë, se kanë kryer punime ndërtimore, rikonstruksione rrugore, asfaltime, përmirësime rrugore, mirëmbajtje rrugore ujësjellësa, të cilat dëshmojnë se disponojnë eksperiencën e nevojshme për sa i përket objektit të prokurimit të realizuar nga autoriteti kontraktor. Pra komponentët e sipërcituar të cilët karakterizojnë kontratën objekt-prokurimi nuk kërkojnë ekspertizë apo eksperiencë të ndryshme nga ato të dëshmuara nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues. Komisioni gjykon, se krahasueshmëria e kontratave nëse janë të ngjashme nuk ka të bëjë vetëm me natyrën e kontratës referuar një analize të përgjithshme dhe sipërfaqësore, nëse ajo është një kontratë pune publike, por si autoriteti kontraktor në momentin e vlerësimit të ofertave, por edhe operatori ekonomik në momentin e hartimit të ofertës duhet të mbajë në konsideratë të gjithë komponentët që karakterizojnë kontratën duke iu referuar qëllimit (ratio legis) të kërkesës **për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshatshëm cilësie**. Në rastin konkret, kontratat e paraqitura nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues janë punë

publike me objekte por dhe zëra të preventivit me natyrë të ngjashme me objektin e prokurimit. Sa më sipër, referuar kushteve të vendosura nga autoriteti kontraktor për sa i përket eksperiencës së ngjashme, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur, nga anëtari i bashkimit operatori ekonomik ekonomik “Curri” SHPK, konstatojmë, se ky i fundit nuk përmbush kushtin e parë të vendosur nga autoriteti kontraktor për një për një objekt të vetëm *në një vlerë jo më të vogël se 50%* e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, kështu që rrjedhimisht KPP verifikoi dokumentacionin e dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik “Curri” SHPK për plotësimin e kushtit të dytë *“Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht referuar dhe kontratës së bashkëpunimit në të cilën është përcaktuar dhe përqindja e secilit anëtarë ku operatori “Curri” SHPK ka marrë përsipër 50.96 % të kontratës e shprehur në vlerë 509.600.000 lekë pa TVSH, pra ky operatorë duhet të ketë disa punë të ngjashme ku vlera totale e tyre të jetë 509.600.000 lekë pa TVSH”*.

KPP nga shqyrtimi dhe verifikimi i të gjitha elementeve të kontratave të sipërcituara, duke nisur që nga objekti i tyre, vërtetimi i realizimit (si dokument i përcaktuar në kriter për vërtetueshmërinë e punëve të ngjashme), përshkrimi i punimeve në situacion apo faturë tatimore si pjesë përbërëse e kontratave, si dhe afatit të realizimit të tyre, nga të gjitha kontratat e dorëzuara në sistemin e prokurimeve elektronike nga anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Curri” SHPK për vërtetueshmërinë e përmbushjes së kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.1 të dokumenteve standarde të tenderit, mori në shqyrtim vërtet këto kontrata **1- Kontratë nr. 1054/2 prot., datë 29.05.2020, lidhur ndërmjet Fondit Shqiptarë të Zhvillimit dhe bashkimit të operatorëve ekonomik “Curri” sh.p.k 50.001% & “Alba Konstruksion” shpk 49.999 % me objekt: “Përmirësim i nyjes së Hyrjes – Daljes Fishtë dhe përmirësimi i shtresave rrugore për segmentin Rrugë Nacionale – Fishtë, L=3,050 ml” dhe “Përmirësim i shtresave rrugore në segmentin: Rrethrotullimi i rrugës Nacionale Kopluk – Kryqëzimi Dedaj L = 11,900 ml, Bashkia Malësi e Madhe” me vlerë të realizuar XXX,XXX,XXX lekë me TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi, situacion, akt kolaudimi, certifikate e marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore. 2- Kontratë nr. 1656 prot., datë 27.07.2020, lidhur ndërmjet Fondit Shqiptarë të Zhvillimit dhe bashkimit të operatorëve ekonomik “Curri” sh.p.k 50.001% & “Alba Konstruksion” shpk 49.999 % me objekt: “Përmirësimi i shtresave rrugore Boboshticë – Dardhë L = 9480m” me vlerë të realizuar XX,XXX,XXX lekë me TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi, situacion, akt kolaudimi, certifikate e marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore. 3- Kontratë nr. 1378 prot., datë 26.06.2020, lidhur ndërmjet Fondit Shqiptarë të Zhvillimit dhe bashkimit të operatorëve ekonomik “Curri” sh.p.k 50.001% & “Alba Konstruksion” shpk 49.999 % me objekt: “Përmirësimi i shtresave rrugore në unazën e qytetit Pukë L=1000m” me vlerë të realizuar XX,XXX,XXX lekë me TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi, situacion, akt kolaudimi, certifikate e marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore. 4- Kontratë nr. 1612 prot., datë 27.04.2021, lidhur ndërmjet Fondit Shqiptarë të Zhvillimit dhe bashkimit të operatorëve ekonomik “Curri” sh.p.k 50.001% & “Alba Konstruksion” shpk 49.999 % me objekt: “Përmirësimi i shtresave**



rrugore në Rrugë të brëndshme në qytetin Korçë, në Drenovë dhe në Boboshticë” me vlerë të realizuar XX,XXX,XXX lekë me TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi, situacion, akt kolaudimi, certifikate e marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore. **5-**Kontratë nr. 4547/5 prot., datë 05.09.2016, lidhur ndërmjet Autoritetit Rrugor Shqiptar dhe operatorit ekonomik “Curri” sh.p.k me objekt: “Mirmbajtje rutinë dhe dimërore me performancë e aksit rrugor Qafë Laç – Koman, 32.4 km” me vlerë të realizuar XX,XXX,XXX lekë me TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi, situacion, akt i marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore. **6-** Kontratë nr. 4541/5 prot., datë 21.09.2016, lidhur ndërmjet Autoritetit Rrugor Shqiptar dhe operatorit ekonomik “Curri” sh.p.k me objekt: “Mirmbajtje rutinë dhe dimërore me performancë e aksit rrugor Qafë Bualli – Krastë, 17.7 km” me vlerë të realizuar XX,XXX,XXX lekë me TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi, situacion, akt i marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore. **7-** Kontratë nr. 337 prot., datë 02.12.2020, lidhur ndërmjet Drejtoria e Rajonit Jugor Gjirokastër dhe operatorit ekonomik “Curri” sh.p.k me objekt: “Mirmbajtje rutinë me performancë rruga Tepelenë – Dukaj + rruga K/Salari – Sevastër + rruga Sevastër – Qaf Dushk + rruga Sevastër – Kalivaç + rruga Peshkëpi – Gjormë + rruga Bypass Tepelenë 84 km” me vlerë të realizuar XX,XXX,XXX lekë me TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi, situacion, akt i marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore. **8-** Kontratë nr. 5693/5 prot., datë 14.02.2019, lidhur ndërmjet Bashkisë Vorë dhe operatorit ekonomik “Curri” sh.p.k me objekt: “Rikonstruksion i rrugës industriale pranë Terminalit të Doganës së Tiranës Bashkia Vorë” me vlerë të realizuar XX,XXX,XXX lekë me TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi, situacion, akt kolaudimi, akt i marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore. **9-** Kontratë nr. 14800/7prot., datë 27.09.2017, lidhur ndërmjet Bashkisë Tiranë dhe operatorit ekonomik “Curri” sh.p.k me objekt: “Rikonstruksion i Infrastrukturës rrugore të bllokut të kufizuar nga rrugët Zogu i I – rruga e Dibrës – Siri Kodra – dhe Reshit Petrela” me vlerë të realizuar XXX,XXX,XXX lekë me TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi, situacion, akt kolaudimi, akt i marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore. **10-** Kontratë nr. 8 prot., datë 06.04.2021, lidhur ndërmjet Drejtoria e Rajonit Qendror Tiranë dhe operatorit ekonomik “Curri” sh.p.k me objekt: “Mirmbajtje me performancë Librazhd – Steblevë, Urakë – Golik, Hotolisht – Frarë, Qukës – Qafë Plloçë Loti 1” me vlerë të realizuar XX,XXX,XXX lekë me TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi, situacion, akt i marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore. **11-** Kontratë nr. 8 prot., datë 11.12.2020, lidhur ndërmjet Autoritetit Rrugor Shqiptare dhe operatorit ekonomik “Curri” sh.p.k me objekt: “Mirmbajtje me performancë Librazhd – Steblevë, Urakë – Golik, Hotolisht – Frarë, Qukës – Qafë Plloçë Loti 1” me vlerë të realizuar XX,XXX,XXX lekë me TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi, situacion, akt i marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore. **12-** Kontratë nr. 4618 prot., datë 17.07.2018, lidhur ndërmjet Bashkia Malësi e Madhe dhe operatorit ekonomik “Curri” sh.p.k me objekt: “Rikualifikim i sheshit në Koplík Sipërm” me vlerë të realizuar X,XXX,XXX lekë me TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi, situacion, akt kolaudim, akt i marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore. **13-** Kontratë nr. 96 prot., datë 25.01.2021, lidhur ndërmjet Këshillit Qarkut Tiranë dhe operatorit ekonomik “Curri” sh.p.k me objekt: “Sistemim, asfaltim rruga Cekrez – Morinë (lagja e kodralinjve) Njësia Administrative Zall-Herr” me vlerë të realizuar XX,XXX,XXX lekë me

TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi, situacion, akt kolaudim, akt i marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore. **14-** Kontratë nr. 1703 prot., datë 19.06.2017, lidhur ndërmjet Bashkisë Malësi e Madhe dhe operatorit ekonomik “Curri” sh.p.k me objekt: “Rikualifikim i Qendrës Bajzë Kastrati, Loti 1” me vlerë të realizuar XX,XXX,XXX lekë me TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi, situacion, akt kolaudim dhe fatura tatimore. Komisioni Prokurimit Publik do të marrë në shqyrtim në themel kontratat e sipërcituara, pasi këto kontrata i përmbushin të tre komponentët, pra si komponentin vlefshmëri (që janë brënda afatit pesë vjeçar), si komponentin ngjashmëri (që kanë objekt apo zëra të ngjashëm në situacion dhe fatura si zërat në preventivin e objektit të prokurimit) dhe si komponentin e vlerës së realizuar. Ndërsa për kontratat **1-** Kontratë nr. 5601 prot., datë 07.11.2019, lidhur ndërmjet Bashkisë Malësia e Madhe dhe bashkimit të operatorëve ekonomikë “Curri” sh.p.k 59.1% dhe “Sterkaj” shpk 40.9 % me objekt: “Furnizim me ujë i zonës Koplikut Qendër dhe Koplík i Sipërm” me vlerë të realizuar XXX,XXX,XXX lekë me TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi, situacion, akt kolaudim, akt i marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore. **2-** Kontratë nr. 1703 prot., datë 19.06.2017, lidhur ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizime dhe operatorit ekonomik “Curri” sh.p.k me objekt: “Rikonstruksion i Ujësjellësit të Lagjes 28 Nëntori dhe Skëndërbeu në qytetin e Elbasanit” me vlerë të realizuar XXX,XXX,XXX lekë me TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi, situacion, akt kolaudim, akt i kolaudimit dhe fatura tatimore. **3-** Kontratë nr. 1075 prot., datë 19.03.2020, lidhur ndërmjet Bashkisë Prrenjas dhe operatorit ekonomik “Curri” sh.p.k me objekt: “Rikonstruksion rrjetit shpërndarës i ujësjellësit Prrenjas” me vlerë të realizuar XXX,XXX,XXX lekë me TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi, situacion, akt kolaudimi, certifikate e marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore, Komisioni Prokurimit Publik do të marrë në shqyrtim në themel vetëm ato zëra të situacioneve të këtyre kontratave që kanë ngjashmëri me zërat e preventivit të objektit të prokurimit dhe ato fatura të cilat janë lëshuar brenda afatit 5 vjeçar nga data e njoftimit të kontratës. Ndërsa lidhur me kontratën **1-** Kontratë nr. 3349/12 prot, datë 22.05.2019, lidhur ndërmjet Bashkisë Shkodër dhe operatorit ekonomik “Curri” sh.p.k., me objekt: Loti II “Rikonstruksion rrugë Velipojë Plazh Loti i II-të”, me vlerë të realizuar XX,XXX,XXX lekë me TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi, situacione, akt kolaudim, certifikate e marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore., Komisioni Prokurimit Publik nuk do ta marrë në shqyrtim në themel këtë kontratë, pasi e njëjta kontratë e deklaruar nga anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Curri” SHPK figuron e deklaruar edhe nga anëtari tjetër i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “SMO Union” SHPK, por në këtë rast është deklaruar si një kontratë e lidhur midis dy subjekteve private, ku subjekti “Curri” SHPK është në rolin e investitorit dhe subjekti “SMO Union” në rolin e sipërmarrësit. Për sa kohë që Komisioni Prokurimit Publik nuk ka informacion nëse në procedurën e prokurimit të kësaj kontrate autoriteti kontraktor ka lejuar nënkontraktimin, atëherë nuk mund ta marrë në konsideratë atë, por edhe në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë, i cili kishte barrën e provës në kuptim të nenit 82 pika 1 “Barra Provës” të ligjit 44/2015 “Kodi Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” për të vërtetuar këtë fakt do të kishte paraqitur fakte dhe prova, sërish komisioni nuk do ta kishte marrë në konsideratë, pasi nga shqyrtimi i kontratës

rezulton, se kjo kontratë e lidhur midis dy subjekteve private është lidhur në vlerën e plotë prej 47,839,200, ndërkohë që në nenin 61 “Nënkontraktimi” i ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar (ligj ky në fuqi në kohën e lidhjes së kësaj kontrate) shprehimisht përcaktohej se *Autoriteti kontraktor, në njoftimin e kontratës ose në dokumentet e tenderit, u kërkon ofertuesve të tregojnë në ofertat e tyre përqindjen e kontratës, që ata mendojnë të nënkontraktojnë te palët e treta, si dhe nënkontraktorin e propozuar. Kjo përqindje e caktuar për nënkontraktim duhet të jetë në përpjesëtim me vlerën e kontratës dhe nuk duhet të tejkalojë 40 përqind të vlerës së përgjithshme të kontratës. Autoriteti kontraktor miraton nënkontraktorët e mundshëm përpara lidhjes së nënkontratës me operatorin ekonomik fitues të kontratës publike, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, pa cenuar parimet e përcaktuara në pikën 4 të këtij neni.*

Komisioni Prokurimit Publik, pasi veçoi kontratat e sipërcituara dhe zërat e kontratave të sipërcituara në objektet ujësjellës, të cilat i përmbushin të tre komponentët që karakterizojnë një kontratë të ngjashme, pra elementin kohë, elementin vlerë dhe elementin ngjashmëri, vëren se, nga përlllogaritja e kontratave dhe zërave të ngjashëm në kontratat, situacionet dhe faturat e paraqitura nga anëtari i bashkimit operatori ekonomik “Curri” SHPK, rezulton se janë në vlerën 919.662.514 lekë pa TVSH, ndërkohë që në kriterin e kualifikimit kërkohet punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një kontratë të vetme ose 250.000.000 lekë pa TVSH, për të cilën ky operator nuk ka paraqitur një kontratë të ngjashme për një objekt të vetëm në vlerën jo më të vogël se 50 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës që do të prokurohet, siç është kërkuar në dokumentet e tenderit ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet, dhe referuar përqindjes së marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit nga operatori ekonomik “Curri” SHPK 50.96% ose 509.600.000 lekë pa TVSH. Sa më sipër, nga përlllogaritjet e kryera nga Komisioni për kontratat e ngjashme të marra në shqyrtim rezulton, se anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë ”Curri” SHPK, sipas përqindjes së pjesëmarrjes së këtij të fundit në secilën prej kontratave të paraqitura, vlen të theksohet, se vlera e përgjithshme e punimeve të ngjashme të realizuara në dokumentet e paraqitura nga ky operator ekonomik është 919.662.514 lekë pa TVSH, duke tejkaluar vlerën prej 509.600.000 lekë pa TVSH që duhet të plotësojë ky operator në varësi të përqindjes së marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit, duke e përmbushur kriterin në lidhje me eksperiencën e ngjashme, në vlerën e kërkuar në kriteret e kualifikimit *punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.* Rrjedhimisht ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nga anëtari i bashkimit operatori ekonomik ”Curri” SHPK.

Ndërsa nga verifikimi i dokumentacionit të sipërcituar në pikën III.1.3, të depozituar nga anëtari i bashkimit operatori ekonomik “SMO Union” SHPK, për përmbushjen e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.1 të dokumenteve standarde të tenderit, për sa i përket përmbushjes së kriterit për punime të ngjashme gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të

kontratës, KPP nga shqyrtimi dhe verifikimi i të gjitha elementeve të këtyre kontratave, duke nisur që nga objekti i tyre, vërtetimi i realizimit (si dokument i përcaktuar në kriter për vërtetueshmërinë e punëve të ngjashme), përshkrimi i punimeve në situacion apo faturë tatimore si pjesë përbërëse e kontratave, si dhe afatit të realizimit të tyre, nga të gjitha kontratat e dorëzuara në sistemin e prokurimeve elektronike nga anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë “SMO Union” SHPK për vërtetueshmërinë e përmbushjes së kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.1 të dokumenteve standarde të tenderit, mori në shqyrtim vetëm këto kontrata **1-** Kontratë Referenca P/Punë/2018/GOA/P-14, datë 13.12.2018, lidhur ndërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe bashkimit të operatorëve ekonomikë “SMO Union” sh.p.k 54 % & “Shkëlqimi 07” SHPK 46 %, me objekt: “Rikonstruksion i Unazës Bujqësore të Myzeqesë Segmentet Rrethrotullimi – Imesht – Ngurrës, Fier i Ri – Kashtbardh, Qerret – Kadiaj – Savër Loti 1”, me vlerë të realizuar XXX,XXX,XXX lekë me TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi, akt kolaudimi, certifikata e marrjes në dorëzim, situacione dhe fatura tatimore. **2-** Kontratë nr. 7949/5 prot., datë 19.11.2019, lidhur ndërmjet Autoritetit Rrugor Shqiptar dhe bashkimit të operatorëve ekonomik “Blerimi” shpk 47 % & “SMO Union” sh.p.k 48 % & “A.SH Engineering” shpk 5 %, me objekt: “Ndërtim mure mbajtës dhe pritës në segmentin Kuben-Vasije”, me vlerë të realizuar XX,XXX,XXX lekë me TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi, situacione, akt kolaudimi dhe fatura tatimore. **3-** Kontratë nr. 4697/15 prot., datë 31.08.2018, lidhur ndërmjet Bashkisë Shkodër dhe operatorit ekonomik “SMO Union” sh.p.k, me objekt: “Sistemim asfaltim rruga Qendër Mes – Qendër Dragoc”, me vlerë të realizuar XX,XXX,XXX lekë me TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi, situacione, akt kolaudimi, certifikatë e marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore. **4-** Kontratë nr. 2580 prot., datë 29.03.2019, lidhur ndërmjet Bashkisë Lushnje dhe operatorit ekonomik “SMO Union” sh.p.k, me objekt: “Sistemim asfaltim i rrugës në fshatin Lekaj”, me vlerë të realizuar XX,XXX,XXX lekë me TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi, situacione, akt kolaudimi, certifikatë e marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore. **5-** Kontratë nr. 3822 prot., datë 07.05.2019, lidhur ndërmjet Bashkisë Lushnje dhe operatorit ekonomik “SMO Union” sh.p.k, me objekt: “Sistemim asfaltim i rrugës në fshatin Rrapëz”, me vlerë të realizuar XX,XXX,XXX lekë me TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi, situacione, akt kolaudimi, certifikatë e marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore. **6-** Kontratë nr. 8891/15 prot., datë 04.09.2019, lidhur ndërmjet Bashkisë Shkodër dhe operatorit ekonomik “SMO Union” sh.p.k, me objekt: “Rikonstruksion Rruga Zabelej”, me vlerë të realizuar XX,XXX,XXX lekë me TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi, situacione, akt kolaudimi, certifikatë e marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore. **7-** Kontratë nr. 9261/15 prot., datë 19.08.2019, lidhur ndërmjet Bashkisë Shkodër dhe operatorit ekonomik “SMO Union” sh.p.k, me objekt: “Sistemim asfaltim rruga Ura Mesit – Drisht”, me vlerë të realizuar XX,XXX,XXX lekë me TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi, situacione, akt kolaudimi, certifikatë e marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore. **8-** Kontratë nr. 4127/7 prot., datë 21.09.2018, lidhur ndërmjet Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare dhe operatorit ekonomik “SMO Union” sh.p.k, me objekt: “Mbrojtja e anës së majtë të biefit të sipërm të Digës së Fierzës dhe ndërtimi i vendparkimit të mjeteve lundruese në HEC Fierzë”, me vlerë të realizuar XX,XXX,XXX lekë

me TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi, situacione, akt kolaudimi, certifikatë e marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore. **9-**Kontratë nr. 1283 prot., datë 03.10.2018, lidhur ndërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe bashkimit të operatorëve ekonomik “Nika” shpk 75 % & “SMO Union” sh.p.k 25 %, me objekt: “Rikualifikim urban i Tamarës faza e dytë dhe rikonstruksion i rrugës së Vermoshit”, me vlerë të realizuar XX,XXX,XXX lekë me TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi, situacione, akt kolaudimi, certifikate e marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore. **10-** Kontratë nr. 2682 prot., datë 02.11.2020, lidhur ndërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe operatorit ekonomik “SMO Union” sh.p.k, me objekt: “Rikonstruksioni i Rrugës nga kryqëzimi Dardhë – Arrëz deri në fshatin Nikolicë”, me vlerë të realizuar XXX,XXX,XXX lekë me TVSH, shoqëruar me situacione, akt kolaudimi dhe fatura tatimore. Komisioni Prokurimit Publik do të marrë në shqyrtim në themel kontratat e sipërcituara, pasi këto kontrata i përmbushin të tre komponentët që karakterizojnë një kontratë të ngjashme, pra si komponentin vlefshmëri (që janë brenda afatit pesëvjeçar), si komponentin ngjashmëri (që kanë objekt apo zëra të ngjashëm në situacion dhe fatura si zërat në preventivin e objektit të prokurimit) dhe komponentin e vlerës së realizuar. Ndërsa lidhur me kontratën **1-** Kontratë nr. 6149 prot., datë 21.09.2022, lidhur ndërmjet Bashkisë Krujë dhe operatorit ekonomik “SMO Union” sh.p.k, me objekt: “Sistemim asfaltim i rrugës Halil – Zgërdhesh (Kala)”, me vlerë të realizuar XX,XXX,XXX lekë me TVSH, shoqëruar me situacione, akt kolaudimi dhe fatura tatimore. **2-** Kontratë nr. 24573/8 prot., datë 14.02.2022, lidhur ndërmjet Bashkisë Shkodër dhe operatorit ekonomik “SMO Union” sh.p.k, me objekt: “Sistemim asfaltim i rrugës Oblike Qendër – Lagjia Lami dhe Rashkej”, me vlerë të realizuar XX,XXX,XXX lekë me TVSH, shoqëruar me situacione, akt kolaudimi, certifikatë e marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore. **3-** Kontratë nr. 6117 prot., datë 21.09.2022, lidhur ndërmjet Bashkisë Krujë dhe operatorit ekonomik “SMO Union” sh.p.k, me objekt: “Sistemim asfaltim i rrugëve Lagja në Lindje të Superstradës, Qendër Thumanë Krujë”, me vlerë të realizuar XX,XXX,XXX lekë me TVSH, shoqëruar me situacione, akt kolaudimi dhe fatura tatimore. **4-** Kontratë nr. 6133 prot., datë 21.09.2022, lidhur ndërmjet Bashkisë Krujë dhe operatorit ekonomik “SMO Union” sh.p.k, me objekt: “Sistemim asfaltim i rrugëve Vlash Dobrozi, Dashamiri, e Hekurudha, Njësia Administrative Thumanë, Krujë”, me vlerë të realizuar XX,XXX,XXX lekë me TVSH, shoqëruar me situacione, akt kolaudimi dhe fatura tatimore. **5-**Kontratë nr. 2803 prot., datë 29.04.2021, lidhur ndërmjet Bashkisë Krujë dhe operatorit ekonomik “SMO Union” sh.p.k, me objekt: “Sistemim asfaltim i rrugëve së Ukëve, tapizë, Njësia Administrative Nikël, Krujë”, me vlerë të realizuar X,XXX,XXX lekë me TVSH, shoqëruar me situacione, akt kolaudimi, akt marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore. **6-** Kontratë nr. 2809 prot., datë 29.04.2021, lidhur ndërmjet Bashkisë Krujë dhe operatorit ekonomik “SMO Union” sh.p.k, me objekt: “Sistemim asfaltim i rrugës Engjëlli, Fshati Bilaj, Njësia Administrative Bubq, Krujë”, me vlerë të realizuar X,XXX,XXX lekë me TVSH, shoqëruar me situacione, akt kolaudimi dhe fatura tatimore. **7-** Kontratë nr. 313/12 prot., datë 08.04.2021, lidhur ndërmjet Bashkisë Durrës dhe operatorit ekonomik “SMO Union” sh.p.k, me objekt: “Rikonstruksion rruga Tepelena”, me vlerë të realizuar XX,XXX,XXX lekë me TVSH, shoqëruar me situacione, akt kolaudimi dhe fatura tatimore., Komisioni Prokurimit Publik nuk

do t'i marrë në shqyrtim në themel këto kontrata, pasi nuk e përmbushin kriterin 2.3.1/a të dokumenteve standarde të tenderit në të cilin është përcaktuar, se *për vërtetimin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.* Për sa kohë kontratat e sipërcituara janë kontrata të lidhura me ente publike, anëtari i bashkimit kishte detyrimin ligjor, që në përmbushje të kriterit të sipërcituar, të paraqiste vërtetimet e realizimit nga këto autoritete kontraktore, dhe për sa kohë kontratat kanë mangësi në dokumentacion, Komisioni nuk mund t'i shqyrtojë në themel ato.

Ndërsa lidhur me kontratën **1- Kontratë lidhur më datë 15.09.2018, ndërmjet shoqërisë “SMO Union” ShPK dhe shoqërisë “Curri” ShPK, me objekt: “Rehabilitimi i digës së Gjocaj në Hec Vau Dejës”, me vlerë të realizuar XX,XXX,XXX lekë me TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi, situacione, akt kolaudimi, certifikatë e marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore.** **2- Kontratë lidhur më datë 23.05.2019, ndërmjet shoqërisë “SMO Union” ShPK dhe shoqërisë “Curri” ShPK, me objekt: “Rikonstruksion rruge Velipojë, Plazh, Loti II”, me vlerë të realizuar 46.863.374 lekë me TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi, situacione, akt kolaudimi, certifikatë e marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore.**, Komisioni Prokurimit Publik nuk do t'i marrë në shqyrtim në themel këto kontrata, pasi nga verifikimi në faqen e Agjencisë së Prokurimit Publik në rubrikën open data, skedari Procedura Prokurimi te vitit 2018 - 2019, rezulton se këto dy kontrata janë kontrata publike dhe në të dyja këto kontrata është shpallur fitues dhe është lidhur kontrata me anëtarin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Curri” SHPK, ndërsa kontratat e deklaruara nga anëtari i bashkimit të operatorit ekonomik “SMO Union” SHPK në këtë rast janë deklaruar si kontrata të lidhura midis dy subjekteve private, ku subjekti “Curri” SHPK është në rolin e investitorit dhe subjekti “SMO Union” në rolin e sipërmarrësit. Për sa kohë që Komisioni i Prokurimit Publik nuk ka informacion nëse në procedurën e prokurimit të këtyre kontratave autoriteti kontraktor ka lejuar nënkontraktimin, atëherë nuk mund t'i marrë në konsideratë ato, por edhe në rast se anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë “SMO Union” SHPK i cili kishte barrën e provës në kuptim të nenit 82 pika 1 “Barra Provës”, të ligjit 44/2015 “Kodi Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” për të vërtetuar këtë fakt do të kishte paraqitur fakte dhe prova, sërish komisioni nuk do t'i kishte marrë në konsideratë ato, pasi nga shqyrtimi i kontratave rezulton, se këto kontrata të lidhura midis dy subjekteve private janë lidhur në vlerën e plotë prej XX,XXX,XXX për kontratën 1 dhe vlerën e plotë prej XX,XXX,XXX për kontratën 2, ndërkohë që në nenin 61 “Nënkontraktimi” i ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar (ligj ky në fuqi në kohën e lidhjes së këtyre kontratave) shprehimisht përcaktohej, se *Autoriteti kontraktor, në njoftimin e kontratës ose në dokumentet e tenderit, u kërkon ofertuesve të tregojnë në ofertat e tyre përqindjen e kontratës, që ata mendojnë të nënkontraktajnë te palët e treta, si dhe nënkontraktorin e propozuar. Kjo përqindje e caktuar për nënkontraktim duhet të jetë në përpjesëtim me vlerën e kontratës dhe nuk duhet të tejkalojë 40 përqind të vlerës së përgjithshme të kontratës. Autoriteti kontraktor miraton nënkontraktorët e mundshëm përpara lidhjes së nënkontratës me operatorin ekonomik fitues të kontratës publike, në përputhje me dispozitat e*

*këtij ligji, pa cenuar parimet e përcaktuara në pikën 4 të këtij neni. Në lidhje me kontratën 1-Kontratë nr. 4269/8 prot., datë 09.10.2017, lidhur ndërmjet Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare dhe bashkimit të operatorëve ekonomik “SMO Union” sh.p.k 70 % & “Curri” shpk 30 %, me objekt: “Rikonstruksion i rrugës nga vepra e marrjes tek hyrja e HEC Koman”, me vlerë të realizuar XXX,XXX,XXX lekë me TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi, situacione, akt kolaudimi, certifikatë e marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore., KPP sqaron, se nga verifikimi i formularit të vlerësimit lëshuar nga autoriteti kontraktor Korporata Elektroenergjitike Shqiptare, përcaktohet data e fillimit të kontratës 09.10.2017 dhe data e mbarimit të kontratës 29.06.2018. Gjithashtu, referuar edhe aktit të kolaudimit bashkëlidhur kontratës, rezulton, se ky objekt është kolauduar më datë 29.06.2018, por edhe Fatura tatimore e shitjes nr. 14 është lëshuar më datë 29.06.2018 (Situacion përfundimtar nr. 5). Nga sa më sipër cituar rezulton, se kjo kontratë pune është kryer përpara afatit të përcaktuar në kriterin e kualifikimit, pra përpara pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës objekt-prokurimi, e cila është publikuar në datë 05.07.2023, ndaj dhe Komisioni Prokurimit Publik nuk do ta marrë në shqyrtim këtë kontratë.*

*Për sa i përket kontratës 1- Kontratë nr. 4036/5 prot., datë 04.10.2018, lidhur ndërmjet Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare dhe operatorit ekonomik “SMO Union” sh.p.k, me objekt: “Evadim i materialeve të ngurta në zonën poshtë urës deri tek bashkimi me lumin e Valbonës në HEC Fierzë”, me vlerë të realizuar XXX,XXX,XXX lekë me TVSH, shoqëruar me formular vlerësimi, situacione, akt kolaudimi, certifikatë e marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore., Komisioni pasi shqyrtoi objektin e kontratës, tipologjinë e punimeve, konstaton, se kjo kontratë nuk mund të konsiderohet e ngjashme me objektin e prokurimit, dhe për këtë arsye nuk do të merret në shqyrtim nga komisioni.*

*Komisioni Prokurimit Publik, pasi veçoi kontratat e sipërcituara, të cilat i përmbushin të tre komponentët që karakterizojnë një kontratë të ngjashme, pra elementin kohë, elementin vlerë dhe elementin ngjashmëri, vëren se nga përlllogaritja e kontratave të paraqitura nga anëtari i bashkimit operatori ekonomik “SMO Union” SHPK, rezulton se janë kryer punime të ngjashme nga ky operator në vlerën 267.520.290 lekë pa TVSH, ndërkohë që në kriterin e kualifikimit kërkohet punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet, dhe referuar përqindjes së marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit nga operatori ekonomik “SMO Union” SHPK 49.04 % ose 490.400.000 lekë pa TVSH. Sa më sipër, nga përlllogaritjet e kryera nga Komisioni për kontratat e ngjashme të marra në shqyrtim rezulton, se anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë ”SMO Union” SHPK, sipas përqindjes së pjesëmarrjes së këtij të fundit në secilën prej kontratave të paraqitura, vlen të theksohet, se vlera e përgjithshme e punimeve të ngjashme të realizuara në dokumentet e paraqitura nga ky operator ekonomik është 267.520.290 lekë pa TVSH, duke mos e përmbushur vlerën prej 490.400.000 lekë pa TVSH që duhet të plotësonte ky operator, në varësi të përqindjes së marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit. Në këtë mënyrë ky operator ekonomik nuk e përmbush kriterin në lidhje me eksperiencën e ngjashme në vlerën e kërkuar në kriteret e kualifikimit *punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë**

*pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.* Rrjedhimisht ky kriter do të konsiderohet i papërbushur nga anëtari i bashkimit operatori ekonomik "SMO Union" SHPK. Në këtë kuptim, KPP gjykon, se operatori ekonomik "SMO Union" SHPK me dokumentacionin e paraqitur, nuk provon se ka kryer punë të ngjashme me objektin e prokurimit, pasi kontratat e konsideruara të ngjashme dhe të përlllogaritura nga ana e Komisionit nuk mjaftojnë për të plotësuar vlerën e kërkuar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi. Sa më sipër, KPP sqaron, se mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor, e bën ofertën e bashkimit të operatorëve ekonomikë të pavlefshme.

Referuar gjykimit të mësipërm, KPP, kërkon të sqarojë, se në lidhje me kontratat e dorëzuara nga secili anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimes, të lidhura me Fondin Shqiptar të Zhvillimit, pavarësisht se një pjesë e tyre nuk ka pasur vërtetim realizimi bashkëlidhur kontratës, komisioni i ka marrë në shqyrtim për sa kohë që vetë autoriteti kontraktor që po zhvillon procedurën e prokurimit i ka nënshkruar ato kontrata dhe në fazën e vlerësimit të procedurës së prokurimit nuk është shprehur në lidhje me këtë konstatim, dhe për sa kohë komisioni i vlerësimit të ofertave nuk është shprehur, KPP gjykon që këto kontrata të konsiderohen të vlefshme.

III.1.11. Komisioni rithekson, se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi duhet të paraqesin dokumentacionin e kërkuar në përputhje me kriterin e veçantë të kualifikimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit sa i takon eksperiencës së ngjashme, duke garantuar autoritetin kontraktor për përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.12. Sqarojmë se, bazuar në nenin 82, pika 1 të ligjit 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative i RSH*", barra e provës për të vërtetuar plotësimin e kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, bie mbi operatorin ekonomik, i cili në rastin konkret ka dështuar ta vërtetojë atë.



Në këto kushte, Komisioni gjykon, se bashkimi i operatorëve ekonomikë “Curri” SHPK & “SMO Union” SHPK, nuk përmbush kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në lidhje me eksperiencën e ngjashme, në dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit objekt - ankimi.

Për sa më lart, pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Curri” SHPK & “SMO Union” SHPK nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -t9”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

#### **Vendos:**

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Curri” SHPK & “SMO Union” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur” me Nr. REF-74269-07-04-2023, me objekt: “Ndërhyrje në infrastrukturë rrugore Faza II”, me fond limit 500.000.000 (pesëqind milion) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 24.07.2023 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.
  2. Autoriteti kontraktor të rishikojë arsyet e skualifikimit për anëtarin e bashkimit të operatorit ekonomik “Curri” SHPK dhe të korrigojë shkeljet e konstatuara si më sipër.
  3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera.
  4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Curri” SHPK & “SMO Union” SHPK.
  5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
  6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**

